



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.359/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)-Lista Guxo, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.359/2025, e datës 04.02.2025, parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)-Lista Guxo, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 04.02.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK në të cilën thekson se më datë 02.02.2025 (ditë e diele) pas orës 13:00 është mbajtur tubimi i subjektit politik Guxo në Hotel "Emerald", në Prishtinë. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se në këtë tubim kandidatët për deputet Donika Gërvalla dhe Faton Peci gjatë fjalimeve të tyre kanë bërë shkelje të rëndë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të nenit 34 par.1 nën paragrafi 1.11. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP që të shqiptojë masë sanksionuese ndaj subjektit politik GUXO.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur CD që dëshmon shkeljen e pretenduar.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV, theksohet se ankesa është e pabazë dhe e paqëndrueshme, kjo për faktin se e njëjta, në asnjë moment, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do t'i ndërlihdnin deklaratat me shkeljet e pretenduara dhe e cila, do të binte ndesh me nenin 34 të LZP-së, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 dhe deklaratat e tilla për të cilën parashtruesi pretendon se janë shkelur dispozita të caktuara zgjedhore, konsiderojmë se janë në përputhje të plotë me rregullativen zgjedhore dhe me frymën e një fushate elektorale, këto deklarime i përkasin Lirisë së Shprehjes, që buron nga neni 40 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.359 e palës parashtruese, kundër LVV-së.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV-Lista Guxo, me seli në Prishtinë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që nga video e cila është publikuar në media online Nacionale, ku dëgjohen deklaratat e kandidatëve për deputet të subjektit politik LVV-Lista Guxo, e të cilat deklarata sipas panelit konsiderohen diskurs që zakonisht përdoret gjatë fushatave zgjedhore, prandaj si të tilla nuk mund të konsiderohen si shkelje të pretenduara nga pala ankuuese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, pasi që nuk ka ofruar asnjë provë për vërtetimin e këtyre shkeljeve.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 359/2025 më datën 07.02.2025

Kryesues i Panelit,
Skender Çocaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.